
IN MEMORIAM



BAHTIR SHEHOLLI

(1943 - 2010)

Më 11 mars të vitit 2010, u nda nga jeta kolegu e punonjësi shkencor në fushën e etnomuzikologjisë Bahtir Sheholli(1943-2010). Ai punoi më se 30 vjet në Institutin Albanologjik të Prishtinës, por kontributi i tij la gjurmë edhe gjithandej në qytetin e Prishtinës e në tërë Kosovën.

Bahtir Sheholli, hulumtues në Sektorin e Etnomuzikologjisë – Dega e folklorit të këtij Instituti, u lind më 1943 në fshatin Hërticë – komuna e Podujevës. Shkollën fillore e kreu në Podujevë, shkollën e mesme të muzikës në Prizren, kurse Akademinë e Muzikës – seksioni teorik dhe atë të etnomuzikologjisë i kreu në Beograd. Ndoqi ligjëratat e shkallës së tretë dhe kishte të gatshme mbrojtjen e temës së magistraturës nga fusha e etnomuzikologjisë. Studimet pasuniversitare i ndoqi në Akademinë e muzikës në Beograd.

Bahtir Sheholli gjatë vitit 1979 realizoi një qëndrim studimor-specializues 10 mujor me qëllim të ngritjes shkencore-profesionale në Bashkimin Sovjetik (Universiteti i Leningradit) në kujdesin e etnomuzikologut të njohur, Fjedosij Rupsov.

Në Institutin Albanologjik të Prishtinës B.Sheholli punoi prej vitit 1976, në sektorin e etnomuzikologjisë dhe gjatë periudhës sa punoi në këtë Institut kolegu ynë kreu me sukses shumë punë studimore nga lëmi i etnomuzikologjisë.

Veprimtaria profesionale e shkencore e këtij punonjësi shkencor ishte orientuar dhe përqëndruar në dy fushëveprime studimore: me një anë ai mblodhi dhe incizoi në terren, në treva të ndryshme të banuara me popullatë shqiptare një numër të madh njësisishë etnomuzikologjike nga folklori muzikor, në anën tjetër, krahas kësaj bëri edhe analizimin e studimin e një pjese të mirë të materialit të mbledhur që si rezultat janë një numër artikujsh e punimesh të botuara (publikuara) nga lëmi i etnomuzikologjisë (shqiptare), që shquhen me një vlerë të veçantë profesionale dhe shkencore.

Puna hulumtuese e shkencore e Bahtir Sheholli është e lidhur kryesisht me traditën dhe krijimtarinë muzikore popullore shqiptare. Kështu duke i shkelur gati të gjitha fshatrat anembanë Kosovës, madje edhe disa fshatra të Kosovës lindore, të banuara kryesisht me popullatë shqiptare, ai arriti t'i eksplorojë dhe të mbledhë një material të nduardurt dhe shumë të vlefshëm nga krijimtaria muzikore popullore. Përveç kësaj vitet e fundit, nëpërmjet video-kamerës, filmoi një numër të mirë procesesh të ndryshme nga jeta e përditshme e popullit të lidhura me muzikë. Të gjitha këto paraqesin një dokumentacion me peshë e vlerë të veçantë, jo vetëm për kulturën tonë muzikore popullore, por edhe për kulturën tonë në përgjithësi.

Bahtir Sheholli trajtoi çështje e probleme të ndryshme nga krijimtaria jonë muzikore popullore dhe nga kultura e përgjithshme muzikore e këtij mjedisi. Në këtë kontekst, pos një numri të konsiderueshëm artikujsh, kritikash, recensionesh të botuara në gazeta e revista si: në "Rilindja", në "Fjala", në "Gjurmime albanologjike" seria Folklor-Etnologji, etj. Por, këtu vlen të veçojmë punimin e gjatë në dorëshkrim: Zurla instrument muzikor popullor te shqiptarët në Kosovë. Ky punim që i përket fushës së etno-organologjisë është përfunduar si projekt i Institutit. Studimi mbi zurlen është një monografi kushtuar këtij instrumenti muzikor popullor te shqiptarët në Kosovë dhe traditës së muzikimit në të. Kështu, përveç studimit të veglës si objekt muzikor, në punim bëhet fjalë për përdorimin e tij të gjithanshëm, rolin dhe funksionin e tij në jetën e përditshme të popullit, në mjediset ku përdoret, pastaj lidhjet e këtij instrumenti me procese të ndryshme jetësore etj. Punimit i shtohet rëndësia e vlera shkencore me komponentet komparative që autori i trajton lidhjet dhe veçoritë e veglës dhe përdorimit të saj në Kosovë dhe në mënyrë krahasimtare me ato të trevave dhe të popujve të tjerë të afërt e të largët.

Përveç monografisë në fjalë, Bahtir Sheholli ka botuar edhe një sërë punimesh shkencore me të cilat ka marrë pjesë në kongrese, sesione, tribuna dhe biseda të ndryshme të organizuara në Kosovë dhe më gjerë. Në këto tubime ai gjithëherë me temat e paraqitura dhe me diskutimet e tij, ka arritur të zgjojë interes te studiuesit e huaj dhe të vendit për problemet e trajtuara.

Meqenëse etnomuzikologjia është fushë e gjerë dhe mjaft e shtresuar, Bahtir Sheholli ka pasur mundësinë dhe ka përcjellë në mënyrë profesionale procesin e zhvillimit të traditës së muzikës popullore në Kosovë dhe për-

gjithësisht në trojet shqiptare. Kjo është shprehur në punën hulumtuese të organizuar nga Instituti Albanologjik dhe në punën seleksionuese shumëvjeçare të programit të Revistës së Folklorit Burimor Kosovar në Drenas ku ushtroi edhe aktivitet të dendur në veprimtari të ndryshme etnomuzikologjike. Bahtir Sheholli ka përgatitur një numër të konsiderueshëm emisionesh televizive, emisione të radios me karakter profesional, si dhe për disa vite ishte recensent i botimit të kasetave dhe CD nga folklori muzikor në Kosovë.

Përveç punimeve shkencore të zëna në gojë, Bahtir Sheholli ishte njëri ndër veprimtarët e shquar në Lëvizjen e Pajtimit të Gjaqeve, plagëve e ngatërresave, bashkë me Anton Çettën dhe bashkëpunëtorët e tij. Bahtir Sheholli e përjetoi edhe çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës, për të cilën vijimisht u interesua dhe u angazhua në mënyrë të ndryshme.

Mehmet HALIMI